MESAZH PËRSHËNDETËS

NË VEPRIMTARINË PËRKUJTIMORE KUSHTUAR DRITA IVANAJT DHE TRASHËGIMISË PATRIOTIKE TË FAMILJES IVANAJ

M•M IVANAJ FOUNDATION INSTITUT

Fondacioni M. & M. Ivanaj Institut, në bashkëpunim me Komisionin e Historisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizojnë:

VEPRIMTARI PËRKUJTIMORE

FAMILJA IVANAJ
NJË TRASHËGIMI NË SHËRBIM TË SHQIPËRISË

Nikollë Ivanaj | Martin Ivanaj | Mirash Ivanaj | Drita Ivanaj

15 qershor 2026,
ora 11:00
Akademia e Shkencave e Shqipërisë
Salla Aleks Buda

M•M IVANAJ FOUNDATION INSTITUT

PROGRAMI

11:00 – Hapja e veprimtarisë
Përshëndetje nga Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Përshëndetje nga Zv. Ministrja e Ministrisë së Arsimit
Znj. Orjana Osmani

Përshëndetje nga **Z. Mal Berisha**

Z. Gjovalin Shkurtaj
"Katër pështarë atdhetarie, me ndihmesa të shquara për arsimin dhe kulturën shqiptare nga Malësia e Madhe"

Znj. Nevila Nika
"Vëllezërit Ivanaj - Dy figura të spikatura të botës shqiptare"

Z. Hasan Bello
"Një profil intelektual mbi rolin dhe kontributin e Martin Ivanajt në vitet 20-30-të"

Znj. Alba & Z. Dario Haruni
"Nikolla Bej Ivanaj, dimensioni i tij në dokumentet arkivore të Arkivit Qendror Shtetëror"

Z. Mentor Kikia
"Ivanaj, një pasqyrë ku shkolla shqipe duhet të vazhdojë të shikohet ende"

Diskutim me pjesëmarrësit
Mbyllja e veprimtarisë

Mal Berisha

Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë
15 qershor 2026
New York – Tiranë

Të nderuar pjesëmarrës në këtë ngjarje shumë kuptimplotë përkujtimore kushtuar tashmë të ndjerës Drita Ivanaj, pinjolles së fundit të një familjeje të madhe patriotike malësore shqiptare,

E ndiej si nder, detyrim dhe privilegj të them dy fjalë në këtë video-lidhje, për shkak të pamundësisë që pata për të marrë pjesë personalisht, pasi nuk gjendem në atdhe.

Njohja ime me Drita Ivanajn erdhi vonë, për shkak të rrethanave të jetës dhe heshtjes së plotë që regjimi komunist kishte vendosur ndaj këtyre emrave të mëdhenj të patriotizmit shqiptar, të arsimit, të legjislacionit, të kodifikimit të së drejtës zakonore shqiptare dhe të kontributit të tyre të jashtëzakonshëm në ruajtjen e traditës më të mirë të popullit shqiptar.

Megjithatë, kur u ula dhe shkrova artikullin e zgjeruar biografik kushtuar Fondacionit “Martin dhe Mirash Ivanaj” – një xhevahir në qendër të Tiranës – nuk isha krejt i panjohur me atë që përfaqësonte fondacioni dhe vetë themeluesja e tij, Drita Ivanaj.

Në fëmijërinë time të hershme, kur shkoja në shkollën 7-vjeçare në Tropojë, babai im më thoshte:

“Kjo shkollë është hapur qysh në kohën e Mbretit Zog. Tropoja ishte nënprefekturë në atë kohë. Falë një ministri patriot, një katolik nga shqiptarët e Malit të Zi, me emrin Mirash Ivanaj, ne, nxënësit e asaj kohe, që nga klasa e parë, çdo ditë rreshtoheshim përpara shkollës sipas klasave dhe, bashkë me mësuesit e kohës, këndonim me zë të lartë, në mënyrë korale, Himnin Kombëtar Shqiptar.

Kjo zgjati edhe pasi ai nuk ishte më ministër, deri më 8 prill të vitit 1939, një ditë pas pushtimit italian, ditën kur

mësuesit tanë dolën përpara nesh dhe, duke qarë me dënesë, na thanë:

‘Prej sot neve nuk na lejohet ta këndojmë më Himnin Kombëtar Shqiptar, sepse Italia fashiste e ka pushtuar Shqipërinë.’”

Për meritat e familjes Ivanaj do të flasin profesorët dhe studiuesit e nderuar të planifikuar sot në këtë ngjarje përkujtimore.

Por unë e them me zemër të hapur dhe me ndjenjën më të lartë të përgjegjësisë se njohjen e drejtpërdrejtë me Drita Ivanajn e kam konsideruar një bekim nga Zoti, një moment edukimi, iluminimi dhe përmbushjeje shpirtërore e patriotike.

Ajo ishte për mua jo vetëm trashëgimtarja e denjë e një familjeje të shquar shqiptare, por edhe mishërimi i vlerave më të larta njerëzore, qytetare dhe kombëtare, të cilat familja Ivanaj i ruajti me dinjitet dhe sakrificë gjatë gjithë jetës së saj.

Për mua, jeta e saj ishte një leksion shqiptarie, një dëshmi se e keqja mund të mposhtet, sado e madhe të jetë ajo. Ishte shembulli i një zonje që, megjithëse u rrit në vetmi dhe me prindër që përjetuan më të keqen e imagjinueshme nga dy regjime barbare, si ai fashist italian dhe ai komunist që rënduan mbi Shqipërinë, nuk e la kurrë në mes misionin e saj në të mirë të atdheut.

Veprimtaritë e organizuara në mjediset e Fondacionit “Martin dhe Mirash Ivanaj”, të moderuara nga vetë Drita jonë, mbeten ndër momentet më të rëndësishme të jetës sime.

Prandaj, i bashkohem me respekt nderimeve, bisedave, kujtimeve, vlerësimeve dhe homazheve që i kushtohen sot Drita Ivanajt dhe tërë atij brezi familjar që sakrifikoi gjithçka për atdheun tonë të dashur dhe për mbarë shqiptarinë – familjes IVANAJ.

Thënë këtë, unë do të shtoja se kjo ngjarje përkujtimore nuk duhet të mbetet vetëm brenda kufijve të kujtimeve, vlerësimeve dhe homazheve, por të shoqërohet edhe me një propozim konkret institucional.

Do të ishte një nder i veçantë për kombin tonë që emri i Mirash Ivanajt t’i jepej jo vetëm një shkolle, por një institucioni arsimor të një rëndësie të veçantë kombëtare, në përputhje me kontributin e tij të jashtëzakonshëm në arsimin shqiptar.

Po ashtu, do të ishte krejt e natyrshme që një gjykatë në Veriun e Shqipërisë të mbante emrin e Martin Ivanajt, si simbol i drejtësisë, integritetit, profesionalizmit dhe përkushtimit ndaj shtetit shqiptar.

Ndërsa një gjimnaz me emrin e Drita Ivanajt do të ishte një shenjë e merituar mirënjohjeje për përkushtimin e saj të jashtëzakonshëm në ruajtjen, pasurimin

dhe përcjelljen e trashëgimisë së kësaj familjeje të shquar shqiptare.

Kështu, emrat e tyre nuk do të mbeteshin vetëm në kujtesën e brezit tonë, por do të vazhdonin të jetonin përmes institucioneve që edukojnë, formojnë dhe i shërbejnë shoqërisë shqiptare, ashtu siç bënë ata vetë gjatë gjithë jetës së tyre.

Mos të harrojmë se edhe sot ka shumë shkolla dhe institucione publike që mbajnë emra personash, merita e vetme e të cilëve ka qenë pjesëmarrja në përndjekjen e patriotëve shqiptarë, siç ishte edhe familja Ivanaj, dhe, jo rrallëherë, në veprimtari që historia i ka gjykuar rëndë.

Tanimë, Shqipëria e ka bërë një gjysmë hapi duke emërtuar shkolla me emrat e Fishtës, Koliqit, Kaçorrit, Meshkallës, Konicës dhe figurave të tjera të rëndësishme të kulturës, arsimit dhe qëndresës ndaj totalitarizmit. Megjithatë, ende nuk njihet një shkollë publike që të mbajë emrin e Mirash Ivanajt, njeriut që lidhet drejtpërdrejt me reformën më të rëndësishme të arsimit shqiptar para Luftës së Dytë Botërore.

Kjo mungesë nuk është thjesht një çështje emërtimi. Ajo përfaqëson një detyrim ende të papërmbushur ndaj një prej figurave më të ndritura të historisë sonë kombëtare, një personalitet që e kuptoi më mirë se kushdo se forca e një

kombi buron nga arsimi, kultura dhe formimi qytetar i brezave të rinj.

I paharruar qoftë kujtimi i Drita Ivanajt dhe i gjithë familjes së saj fisnike, që me veprën, sakrificat dhe shembullin e tyre i kanë lënë kombit shqiptar një trashëgimi të çmuar patriotizmi, diturie dhe shërbimi ndaj atdheut.

LAVDI!